

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

**EK
NH
SB**

PA II 3/2014

Më 7 gusht 2014

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarësh së EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova si kryetare e kolegjit, gjyqtarësh së EULEX-it Esma Erterzi dhe gjyqtarësh së Gjykatës Supreme Valdete Daka si anëtarë të kolegjit, në praninë e zyrtarësh ligjorësh të EULEX-it Kerry Moyes, në cilësi të procesmbajtëses, në vend të zyrtarësh ligjorësh të EULEX-it Natalie Dawson, në lëndën penale kundër të pandehurve:

E K dhe **S B**, të liruar në shkallë të parë, dhe të **DËNUAR** në shkallë të dytë për veprat penale në vijim:

Krime të luftës kundër popullatës civile, në bashkëkryerje në kundërshtim me nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (tani e tutje KP RSFJ), tani e dënueshme edhe sipas nenit 31 dhe 153 paragrafit 2.1 dhe 2.14 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së) në lidhje me nenin 3 të përbashkët me katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 (tani e tutje neni i përbashkët 3) dhe nenit 13.2 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, Protokollit shtesë i Konventës së Gjenevës të vitit 1949 (tani e tutje Protokollit shtesë II),

DHE

N H, i liruar në shkallë të parë, dhe i **DËNUAR** në shkallë të dytë për veprat penale në vijim

Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, nga neni 305 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës 2004 (tani e tutje KPK), tani e dënueshme sipas nenit 388 paragrafit 1 dhe 2 të KPRK-së,

Duke vendosur në lidhje me ankesat e paraqitura më 17 prill 2014 nga:

1. Avokati mbrojtës Ethem Rugova në emër të E K
2. Avokati mbrojtës Vigan Rugova në emër të S B
3. Avokati mbrojtës Hajrip Krasniqi në emër të N H

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 30 janar 2014;

Duke marrë parasysh mendimin e prokurorit të shtetit të datës 21 maj 2014,

Pas mbajtjes së seancës publike më 7 gusht 2014, ku të gjitha palët ishin të njoftuar me kohë,

Të pranishëm:

I pandehurit E K, i përfaqësuar nga Ethem Rugova
I pandehurit S B, i përfaqësuar nga Qazim Xharra
Prokurorja e EULEX-it, Judit Eva Tatrai
Pala e dëmtuar, WDB, e përfaqësuar nga Vladimir Mojsilovic

Në mungesë të:

Të pandehurit N H dhe të përfaqësuesit të tij ligjor Hajrip KRASNIQI

Në përputhje me nenet 430(1.2) dhe (2), 410(3), 411(1) dhe 415 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje KPPK),

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 14 gusht 2014, në përputhje me nenin 420, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Ankesat e paraqitura nga E K dhe S B, PRANOHEN PJESËRISHT.**
- 2. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i datës 30 janar 2014 NDRYSHOHET PJESËRISHT sa i përket E K dhe S B në lidhje vetëm me dënimin e tyre.**
- 3. E K dhe S B dënohen me dy (2) vjet burgim.**
- 4. Ankesa e paraqitur nga N H PRANOHET.**
- 5. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit i datës 30 janar 2014 ANULOHET PJESËRISHT sa i përket N HT, dhe të bashkakuzuarve të tjerë M H, M H, N B dhe J K, në përputhje me nenin 419 të KPPK-së.**
- 6. N H, M H, M H, N B dhe J K, të gjithë LIROHEN nga vepra penale dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale, nga neni 305 paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës 2004.**

ARSYETIMI

A. HISTORIA E PROCEDURËS

- Më 30 mars 2011, në Gjykatën e Qarkut në Prizren prokurori special ngriti aktakuzën PPS nr. 75/2010 kundër të pandehurit E K dhe një të bashkakuzuari tjetër. Këta të pandehur u akuzuan për veprat penale Krime të luftës kundër popullatës civile më 17 dhe 18 korrik 1998. Aktakuza e njëjtë ngarkon të pandehurin N H (si dhe katër të bashkakuzuar) për dhënie të ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale.
- Më 29 prill 2011 kjo aktakuzë u konfirmua pjesërisht me aktvendimin KA nr. 76/2011.

- c. Më 28 qershor 2011 filloi gjykimi i parë në Gjykatë të Qarkut në Prizren.
- d. Më 2 gusht 2011, kolegji lëshoi aktgjykimin P 134/2011. E K dhe N H u shpallën fajtorë. K u dënua me pesë (5) vjet burgim kurse H me gjashtë (6) muaj burgim..
- e. Më 31 maj 2012, në Gjykatën e Qarkut në Prizren prokurori special ngriti aktakuzën PPS nr. 75/2010 kundër të pandehurit S B, me të cilën u akuzua për vepër penale Krime të luftës kundër popullatës civile në Optrushë më 17 dhe 18 korrik 1998.
- f. Më 30 maj 2012 kjo aktakuzë u konfirmua me aktvendimin KA 97/2012.
- g. Më 4 shtator 2012 Gjykata Supreme e Kosovës vendosi lidhur me ankesat e paraqitura nga avokati mbrojtës i KT dhe i HT. Aktvendimi Ap-Kz 20/2012 anuloi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren nr. P 134/2011 (përveç pjesën që ka të bëjë me lirimin e të bashkakuzuarit Haxhi Mazreku), dhe lënda u kthye në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim.
- h. Më 7 nëntor 2012 gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut në Prizren bashkoi procedurën penale kundër të pandehurve K dhe H (me të bashkakuzuarit e mbetur) me procedurën penale të të pandehurit B nën numrin e lëndës P 249/2012.
- i. Më 30 nëntor 2012 filloi shqyrtimi gjyqësor.
- j. Më 1 shkurt 2013 trupi gjykues lëshoi aktgjykimin me të cilin lirohen të gjithë të pandehurit.
- k. Më 28 maj 2013 prokurori special paraqiti ankesë me kohë.
- l. Më 30 janar 2014 Gjykata e Apelit lëshoi aktgjykimin në lëndën PAKR 271/2013 me të cilin e pranon ankesën e prokurorit special dhe e ndryshon aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit me numër P 249/2013.
- m. Gjykata e Apelit shpall të pandehurit K dhe B fajtorë për vepër penale Krime të luftës kundër popullatës civile më 17 dhe 18 korrik 1998, dhe shpall fajtor të pandehurin N H, si dhe katër të bashkakuzuar, për vepër penale dhënie të ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale.
- n. Të pandehurit K dhe B u dënuan secili me nga pesë (5) vjet burgim.
- o. I pandehuri H u dënua me gjashtë (6) muaj burgim, me kusht për një (1) vjet.
- p. Më 17 prill 2014 avokati mbrojtës paraqiti ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PAKR 271/2013 në emër të të pandehurve K, B dhe H.
- q. Më 21 maj 2014 prokurori i shtetit paraqiti mendim lidhur me këto ankesa.

B. QËNDRIMET E PALËVE

a. Avokati mbrojtës:

K

Propozon: Aktgjykimin i Gjykatës së Apelit PAKR nr. 271/2013 i datës 30.1.2014 duhet të: ndryshohet, duke e liruar të pandehurin K ose t'i shqiptohet një masë më e lehtë, ose të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

- i. Dispozitivi është i pakuptueshëm sa i përket datës dhe numrit të aktgjykimit i cili është anuluar; pikat 1 dhe 2 specifikojnë data dhe numra të ndryshëm.
- ii. Në paragrafin 19 të aktgjykimit, Gjykata e Apelit pajtohet me vërtetimin e fakteve nga trupi gjykues, megjithatë arrin një përfundim ndryshe nga përfundimi i trupit gjykues lidhur me praninë e të pandehurit K.

- iii. Dëshmitaret WDB dhe WSB i kanë ndryshuar më herët dëshmitë e tyre lidhur me atë se çfarë kishin të veshur kryerësit dhe nëse ishin të armatosur. Ka pak gjasa që WSB ta njihte të pandehurin K në praninë e 2,000 njerëzve.
- iv. Gjykata e Apelit nuk tregon pse njësitë në të cilin i pandehuri K kishte marrë pjesë ishte njësitë i organizuar me urdhra nga eprorët që i nënshtrohet konventave ndërkombëtare. Nuk është vërtetuar se cili njësitë i UÇK-së ka marrë pjesë dhe kush e komandonte atë.
- v. I pandehuri K është shpallur fajtor në bazë të bashkëkryerjes. Gjykata e Apelit ka konstatuar se pjesëmarrja e të pandehurit K në vete është fajësuese, që e bën atë përgjegjës. Kjo do të thotë se mijëra forca serbe që kanë marrë pjesë në sulme dhe në krime në Kosovë duhet të sillen para drejtësisë.
- vi. Gjykata e Apelit i kundërshton gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës në aktgjykimin Ap-Kz nr. 20/2012. Kolegjet në këto dy vendime janë në shkallë të dytë.
- vii. A mund të klasifikohen këta njerëz, të armatosur rëndë, si ‘civilë’? Nëse ishin ‘civilë’ do të duhej të ishin larguar nga ajo zonë. Dispozitat për krime të luftës nuk duhet të zbatohen.
- viii. Gjykata e Apelit gjen se i pandehuri K ishte lënduar kur ishte në spital më 18 gusht 1998, megjithatë në atë datë në fakt kishte shkuar për kontrollë mjekësore për një plagë që e kishte pësuar dhe ishte shtrirë në spital para kësaj date. Gjykata e shkallës së parë gjen se për këtë arsye ai nuk ka mundur të jetë pjesë e sulmit më 18 korrik 1998.
- ix. Edhe nëse i pandehuri K është fajtor dënimi është i lartë.

B

Propozon: I pandehuri B duhet të lirohet, ose aktgjykimi i Gjykatës së Apelit PAKR nr. 271/2013 i datës 30.1.2014 duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

- i. Dispozitivi është i pakuptueshëm sa i përket datës dhe numrit të aktgjykimit i cili është anuluar; pikat 1 dhe 2 specifikojnë data dhe numra të ndryshëm.
- ii. Prania e të akuzuarit nuk e vërteton fajësinë e tij pasi që nuk është dëshmuar se në çfarë cilësie ishte i pranishëm dhe çfarë veprime inkriminuese ka ndërmarrë.
- iii. A ishte grupi në të cilin pretendohet se ka marrë pjesë në këtë sulm një grup i organizuar nën urdhra të eprorëve, apo thjesht vetëm fshatarë të organizuar?
- iv. Çështjet kryesore janë: a ishte i pandehuri B pjesëtar i UÇK-së; a kishte të veshur uniformë ushtarake; a mbante armë; çfarë veprime kishte ndërmarrë; a ishin ‘civilë’ personat në shtëpinë e familjes, dhe kusht kishte shtënë i pari? Pozicioni i të pandehurit B është se fshatarët e organizuar kanë shtënë si kundërpërgjigje ndaj sulmit kundër tyre.
- v. Gjykata e Apelit nuk ka arritur të japë arsye pse i ka besuar dëshmisë së WDB dhe të WSB. Këto dëshmitare kanë dhënë dëshmi kundërthënëse dhe i kanë ndryshuar dëshmitë e tyre. Prandaj gjendja faktike ishte vërtetuar gabimisht.
- vi. Gjykata e Apelit i kundërshton gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës në aktgjykimin Ap-Kz nr. 20/2012.
- vii. Edhe nëse i pandehuri B është fajtor dënimi është i lartë.

H

Propozon: Aktgjykimi i kundërshtuar duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe në rigjykim.

- i. Dispozitivi është i paqartë sa i përket datës dhe numrit të aktgjykimit i cili është anuluar; pikat 1 dhe 2 specifikojnë data dhe numra të ndryshëm.
- ii. Aktgjykimi kundër të pandehurit H nuk është i formës së prerë sepse procedura kundër të bashkakuzuarit K ende nuk ka përfunduar, dhe prandaj aktakuza kundër të pandehurit H është e paligjshme. Këto ndjekje penale nuk duhet të ndodhin paralelisht.
- iii. Aktgjykimi i kundërshtuar është i pakuptueshëm sa i përket fakteve relevante dhe vendimtare. Ka kundërthënie në mes të arsyesimit të aktgjykimit sa i përket deklaratave të dhëna dhe asaj që është thënë lidhur me faktet vendimtare. Gjendja e vërtetuar faktike është ndryshe nga ajo e paraqitur në arsyetim.
- iv. Sjellja e ndaluar në nenin 305(1) është e kufizuar me dhënien e ndihmës me qëllim të shmangies së zbulimit.
- v. Interpretimi i drejtpërdrejtë i *'dhënies së ndihmës kryerësve në shmangien e zbulimit të veprës'* nga neni 305(1) lidhet me fshehjen ose mbulimin e identitetit të kryerësit, dhe me dhënien e ndihmës kryerësit, identiteti i të cilit është i njohur, që të mos kapet.
- vi. Përdorimi i fjalës 'zbulim' në nenin 305(1), si dhe në disa vepra të tjera brenda KPK-së, është e kufizuar për situatat ku i kryerësi nuk është gjetur ose kapur.
- vii. Dhënia e dëshmisë së rrejshme si dëshmitar gjatë fazës së procedurës paraprake pasi kryerësi ishte zbuluar nuk mund të mbulohet me nenin 305(1). I pandehuri K ishte më herët në paraburgim kur i pandehuri H ishte marrë në pyetje. Kjo situatë shkon përtej formulimit të nenit 305(1) dhe prandaj është në kundërshtim me nenin 7 të KEDNj-së, me nenin 33(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me parimin *nullum crimen, nulla poena sine lege*.

b. Prokurori i shtetit:

Propozon: Ankesat janë jomeritore dhe duhet të refuzohen si të pabazuara. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit duhet të vërtetohet.

K dhe B

- i. Gabimi në dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është vetëm një gabim shtypi që mund të përmirësohet dhe nuk e justifikon anulimin e aktgjykimit. Është e qartë se cili aktgjykim i nënshtrohej ankesës.
- ii. Neni 426(1) i KPPK-së e lejon Gjykatën e Apelit të pranohet faktet materiale të vërtetuara nga gjykata e shkallës së parë por të arrijë në një përfundim tjetër.
- iii. Vlerësimi i provave të dëshmitareve WDB dhe WSB nga Gjykata e Apelit, dhe konstatimi i kolegjit lidhur me faktet, është i qartë.

- iv. Gjykata e Apelit e ka refuzuar pohimin e mbrojtjes se të pandehurit nuk ishin të pranishëm.
- v. Gjykata e Apelit e pranon se nuk është vërtetuar roli i saktë i të pandehurve në grupin e pranishëm të armatosur të UÇK-së. Kolegji ka gjetur se nuk ishte e domosdoshëm të dëshmohet roli i saktë i tyre sepse ata ishin të pranishëm, të veshur me uniformë, duke mbajtur armë, me grupin e armatosur të UÇK-së që po kryente një sulm për ta çliruar më tutje fshatin nga popullata serbe. Prandaj është plotësuar vepra penale e krimeve të luftës.
- vi. Gjykata e Apelit vërteton se shtëpia e B ishte e zënë me civilë. Nuk është dëshmuar se ata mbanin armë për qëllime të tjera përveç vetëmbrojtjes.
- vii. Pretendimi i mbrojtjes se të shtënat kishin filluar nga shtëpia e B nuk është dëshmuar.
- viii. Dënimi nuk është i ashpër dhe është minimumi i lejuar me ligjin më të favorshëm, atë të KP RSFJ-së.

H

- ix. Ankesa është thjesht një përsëritje e mendimit të ndarë pjesërisht mospajtues të gjyqtarit Timo Vuojolahti, të bashkëngjitur me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të datës 30.2.2014.
- x. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk ka asnjë shkelje të procedurës siç pretendohet.
- xi. Ankesa nuk e kundërshton konstatimin se dëshmia e të pandehurit H është e rrejshme.
- xii. Sa i përket shprehjes, '*zbulimi i kryerësit*', prokurori pajtohet me gjetjet e Gjykatës së Apelit. Kur i pandehuri K ishte në paraburgim ai ende nuk ishte kryerës, por vetëm i dyshuar.

C. GJETJET E GJYKATËS:

C 1 Kompetenca e Gjykatës Supreme

- i. Në përputhje me nenin 21 dhe 22 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199) Gjykata Supreme është kompetente për ta gjykuar këtë çështje.
- ii. Kolegji i Gjykatës Supreme është në përbërje të duhur, në përputhje me nenin 21(6) të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199) dhe me nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053),.

C 2 Ligji i zbatueshëm i procedurës

- iii. Dispozitat kalimtare të Kodit të tanishëm të Procedurës Penale (tash e tutje KPK) përcaktojnë se procedura penale e iniciuar para hyrjes në fuqi të KPK-së, për të cilën shqyrtimi gjyqësor ka filluar por nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tash e tutje KPPK) zbatohen përshtatshëm derisa vendimi të merr formë ne prerë.

- iv. Kjo konfirmohet me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 56/2013, të miratuar në Seancën e Përgjithshme më 23 janar 2014.
- v. Prandaj ligji i zbatueshëm i procedurës penale është KPPK-ja.

C 3 Pranueshmëria e ankesave

- vi. Ankesat janë paraqitur më 17 prill 2014. Prandaj në përputhje me nenin 398(1) të KPPK-së ankesat janë paraqitur me kohë dhe janë të pranueshme.

C 4 Gabimet procedurale

- vii. Kolegji pajtohet me prokurorin e apelit se gabimi në dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 30 janar 2014 është gabim shtypi. Kolegji konsideron se qëllimi i Gjykatës së Apelit është shumë i qartë, duke u bazuar në njohuritë e të gjitha palëve në procedurë lidhur me përparimin e kësaj lënde.

C 5 E K dhe S B – GJETJA E FAJËSISË

C 5.1 A ishte i pranishëm E K në mbrëmjen e 17 korrikut 1998?

- viii. Kolegji i Gjykatës Supreme i konsideron me kujdes deklaratat e ndryshme të palëve të dëmtuara, WDB dhe WSB. Këtu përfshihen procesverbalet e shqyrtimit të dëshmitarëve të datës 26 dhe 27 tetor 2010; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 4 dhjetor 2012; procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i datës 28 dhe 29 qershor 2011.
- ix. Kolegji konstaton se këto deklarata janë plotësisht të qëndrueshme dhe ofrojnë informata të hollësishme në lidhje me E K dhe S B. Prandaj, kolegji gjen se këto deklarata ofrojnë dëshmi të besueshme dhe të padiskutueshme.
- x. Më saktë, në lidhje me të pandehurin K, dëshmitarja WDB ishte e qartë dhe e qëndrueshme në të gjitha fazat e procedurës se e kishte dëgjuar dikë, në gjuhën shqipe, ‘D, mos dil jashtë’, D ishte emri i burrit të saj, Mit, dhe i tërë fshati e quante ashtu. WDB është po ashtu e sigurt se personi i cili thërriste ishte i pandehuri E K, të cilit i referohet si ‘J.’
- xi. Më procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 28 qershor 2011, WDB vetë e pranon se nuk ka mundur ta dallojë se zëri ishte i të pandehurit K, por se burri i saj po. Ajo deklaroi, ‘Si të mos e njoh atë kur ata janë fqinjët tanë?... Ata shoqëroheshin dhe pinin bashkë në shitore.’ Kur Ethem Rugova e pyeti më herët në shqyrtim, në emër të E KT, WDB tha se nuk i njihte të gjithë fshatarët e Optrushës, por ‘burri i saj shoqërohej me të gjithë’.
- xii. Përveç kësaj është e qartë se zërin e të pandehurit K e kishte njohur menjëherë. M, burri i WDB, pa qenë i shtyrë, i tregoi asaj se zëri ishte i të pandehurit K. Ajo i tregoi prokurorit më 27 tetor 2010, dhe e konfirmoi para prokurorit në shqyrtim gjyqësor më 28 qershor 2011 se kur desh i ta ndalte burrin e saj të mos shkojë të dera, ai i tha, ‘Mos u brengos, se J po thërret.’ Kjo deklaratë vërteton se M Božanić-i jo vetëm se e ka njohur se zëri ishte i të pandehurit K, por në fakt ai e ka interpretuar faktin se ishte i pandehuri K si arsye për të mos u frikësuar.
- xiii. WDB nuk ishte lëkundur nga deklaratat e dhënë me rastin e marrjes së tërthortë në pyetje. Ajo ishte në mënyrë të qëndrueshme e qartë gjatë tërë procedurës se ky ishte shpjegimi i saj.

- xiv. Kolegji gjen se WDB nuk kishte arsye të dyshojë se burri saj e kishte dalluar se zëri ishte i të pandehurit K. Kolegji gjen se MB nuk ka mundur të gabojë për identitetin e personit të ka folur duke marrë parasysh lidhjen e tyre të mëhershme, dhe secilën herë ka deklaruar se ishte i pandehuri K pa qenë i nxitur asnjëherë nga gruaja e tij.
- xv. **Kolegji gjen përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri K ishte i pranishëm në pronë në mbrëmjen e datës 17 korrik 1998.**

C 5.2 A ishin të pranishëm E K dhe S B në mëngjesin e datës 18 korrik 1998?

- xvi. WDB është po ashtu e qëndrueshme në dëshminë e saj se i kishte parë me sytë e saj të dy EK dhe SB në pronë në mëngjesin e 18 korrikut 1998.
- xvii. Në dëgjimin e dëshmitarëve më 26 tetor 2010 ajo deklaroi se edhe i pandehuri B ishte në oborrin e shtëpisë së saj në mëngjesin e 18 korrikut 1998.
- xviii. WDB e konfirmoi këtë deklaratë në dëshminë e saj në shqyrtim gjyqësor më 28 qershor 2011. Dëshmitarja kishte ca telashe gjatë dëgjimit për t'i kujtuar specifikat, por e konfirmoi se deklarata e saj e dhënë në dëgjimin e dëshmitarëve ishte e saktë.
- xix. Në shqyrtimin gjyqësor të datës 4 dhjetor 2012, prokurori kërkoi nga WDB të përqendrohet saktësisht në mëngjesin e 18 korrikut 1998. Në dëshminë e saj ajo tha se prej atyre personave në oborrin e saj në atë mëngjes e njohu SB. Ajo e konfirmoi se e njohu atë sepse 'e shihja herë par here, se ishim fqinjë ... Kur shkonim në fushat tona, i shihnim ... e njoh sepse erdhi në shtëpi dhe se në shtëpinë e tij kishte një shitore.' Dëshmitarja e konfirmoi se e kishte parë për një periudhë kohore.
- xx. Kolegji gjen se nuk ka dyshim se WDB e ka njohur të pandehurin B, dhe e ka identifikuar saktë në mesin e të pranishmëve në oborrin e saj në mëngjesin e 18 korrikut 1998.
- xxi. Dëshmitarja WSB është në gjendje të jep shtjellime vetëm në lidhje me individin e pranishëm në oborr në mëngjesin e 18 korrikut 1998. Në dëgjimin e saj të dëshmitarëve më 26 tetor 2010 ajo konfirmoi se 'J' ka qenë i pranishëm në oborr, dhe deklaroi se ka 'njohur S BN.' Ajo ka vazhduar duke theksuar se e kishte parë, 'Sin... menjëherë pasi kishte dalë nga shtëpia.'
- xxii. Në dëshminë e saj më 29 qershor 2011, WSB ka deklaruar se kishte njohur SB. Ajo, gjithashtu konfirmoi se kishte parë EK, dhe shtjelloi se si e njohte atë dhe prandaj pse e kishte njohur se ishte ai. Kur është pyetur nëse kishte ndonjë dyshim, WSB deklaroi se nuk kishte dyshime, dhe se ajo ia 'njihte fytyrën.' Kur është pyetur se pse kishte vështirësi që ta njohte atë nga fotografia më tetor 2010, ajo sqaroi se e 'kishte harruar. Unë e kam harruar burrin tim e lëre më dikë tjetër.' Kolegji e gjen bindëse se një person në një situatë të tillë të tmerrshme, dhe me rikujtimin dhe ripërtëritjen e një situatë të tillë pas ngjarjes, mund të ketë vështirësi në njohje. Kolegji nuk gjen shkak për shqetësim në lidhje me besueshmërinë e njohjes së të pandehurit K nga WSB.
- xxiii. Gjatë shqyrtimit gjyqësor më 4 dhjetor 2012, WSB ka konfirmuar se kishte parë E K dhe S B në oborr në mëngjesin e 18 korrikut 1998. Sa i përket të pandehurit B, WSB kishte nevojë për nxitje sidoqoftë ajo sqaroi se kishte pësuar sulm në tru dhe se kishte vështirësi me memorien e saj. Kolegji pranon se kështu ka ndodhur, posaçërisht pasi që është nxitur, dëshmitarja ka qenë në gjendje të jap detaje në lidhje me atë se sa gjatë e kishte njohur të pandehurin B. Këto detaje demonstron se dëshmitarja e ka njohur të pandehurin B për një periudhë të konsiderueshme kohore. Kjo shton peshë në njohjen e BT. Ajo gjithashtu ka konfirmuar se e kishte parë atë sapo kishte dalë nga shtëpia.
- xxiv. Trupi gjykues më 1 shkurt 2013 dhe Gjykata e Apelit më 30 janar 2014 kanë gjetur se deklaratat e E K dhe S B lidhur me vendndodhjen e tyre më 17 dhe 18 korrik

1998 nuk ishin të besueshme. Pas shqyrtimit të të gjitha provave në këtë lëndë, Gjykata Supreme pajtohet me këtë vlerësim.

- xxv. Kolegji gjen përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se që të dy E K dhe S B kanë qenë të pranishëm në oborrin e shtëpisë në mëngjesin e 18 korrikut 1998.**

C 5.3 A kishin E K dhe S B të veshur uniforma dhe a ishin të armatosur?

- xxvi. Në dëgjimin e dëshmitarëve më 26 tetor 2010, WDB nuk specifikon nëse i pandehuri B kishte uniformë apo nëse ishte i armatosur. Kjo dëshmitare ka dhënë prova më 28 qershor 2011 se personat të cilët kanë hyrë në oborrin e saj në mëngjesin e 18 korrikut 1998 kanë qenë të armatosur ‘më pushkë’. Ajo gjithashtu ka theksuar se njëri nga personat të cilët kishin hyrë në oborr ka qenë ‘Si.’
- xxvii. Në dëgjimin e dëshmitarëve më 26 tetor 2010, WDB është e qartë në kujtimet e saj se i pandehuri K ‘kishte uniformë të zezë dhe ishte i armatosur me pushkë.’ Më herët gjatë shqyrtimit ajo kishte deklaruar se uniforma kishte ‘emblemata e UÇK-së në kapela dhe në krahë.’
- xxviii. Më 4 dhjetor 2012, WDB gjithashtu ka konfirmuar se i pandehuri B kishte uniformë, të cilën ajo e përshkruante si ‘rroba të gjelbra shumëngjyrëshe,’ dhe theksoi se kjo ishte ‘uniform kamufllazh’ kur është pyetur nga Prokurori.
- xxix. Në përgjigjen në pyetjen nëse i pandehuri B mbante ndonjë gjë, ajo u përgjigj se ‘ata kishin pushka.’ Kur është pyetur në mënyrë specifike nëse i pandehuri B ishte i armatosur, ajo deklaroi se nuk i kujtohej për shkak të kalimit të kohës që nga ndodhja e incidentit.
- xxx. Më vonë në dëshminë e saj, WDB është pyetur çfarë ishte duke bërë i pandehuri B. Dëshmitarja u përgjigj, ‘Unë nuk isha duke shikuar se çfarë ishin duke bërë sepse kur na kanë mbledhur neve nuk na është lejuar që ta ngrimë kokën për të shikuar, kjo më kujtohet shumë mirë.’ Gjatë procedurës së gjykimit më 29 qershor 2011, WSB ka deklaruar se ‘nga frika ne nuk kemi shikuar,’ duke sqaruar se pse nuk i kujtohen disa detaje specifike.
- xxxi. Kolegji e gjen plotësisht të besueshme se ngjarjet kanë ndodhur në këtë mënyrë dhe për këtë arsye dëshmitarja WDB ka pasur mundësi të kufizuar që t’i shikojë individët që cilët i ka njohur në oborrin e saj. Duke pasur parasysh njohurinë e saj paraprake për këta individë, ajo prapëseprapë ka pasur kohë të mjaftueshme për t’i identifikuar ata dhe të shohë se çfarë kishin të veshur dhe çfarë ishin duke mbajtur.
- xxxii. Kolegji e gjen plotësisht të besueshme se WDB mund të mos ketë qenë në gjendje të kujtoj saktësisht detajet e ngjarjes kur ka dëshmuar më 4 dhjetor 2012, posaçërisht duke pasur parasysh faktin se ajo paraprakisht kishte dhënë shtjellime në dy raste. Prandaj, kolegji i jep rëndësi më të madhe deklaratës së saj në intervistën e 26 tetorit 2010 dhe dëshmisë së saj më 29 qershor 2011, dhe gjen se këto deklarata janë të besueshme dhe se janë në gjendje të reflektojnë më mirë ngjarjet e 18 korrikut 1998.
- xxxiii. Në dëgjimin e dëshmitarëve më 26 tetor 2010, dëshmitarja WSB ka theksuar se shumica e personave në oborr në mëngjesin e 18 korrikut 1998 kishin ‘uniforma kamufllazh dhe të zeza ...,’ për të cilat ajo ka dhënë detaje si kapelat, , maskat, emblemata e UÇK-së dhe vijat e zeza në krah. Ajo deklaroi se, ‘të gjithë ishin të armatosur me pushka.’ Ajo në mënyrë specifike deklaroi se ‘Si gjithashtu kishte uniform dhe ishte i armatosur. Unë e kam parë atë menjëherë pasi kam dalë nga shtëpia.’
- xxxiv. WSB i konfirmoi gjykatës më 29 qershor 2011 se personat në oborr në mëngjesin e 18 korrikut 1998 ishin të armatosur dhe kishin ‘uniforma të gjelbra dhe të zeza.’ Ajo më tutje theksoi se të gjithë personat në oborr ishin me uniforma dhe të

armatosur.’ Kur është pyetur që të jetë më specifike në lidhje me ‘llojin e uniformës’ së E K, WSB bëri pyetje se si mundet dikush ta mbajë në mend llojin e uniformës pas 10 viteve?’ Për arsyet e dhëna në paragrafin xxii, kolegji e gjen të kuptueshme se dëshmitarja nuk ka mundur të jap detaje më specifike për uniformën sesa i kishte dhënë paraprakisht.

xxxv. WSB në mënyrë të qartë konfirmoj gjatë shqyrtimit gjyqësor më 4 dhjetor 2012 se S B kishte uniformë të gjelbër dhe mbante një pushkë.

xxxvi. **Kolegji është i mendimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se të pandehurit K dhe B ishin duke mbajtur uniforma dhe ishin të armatosur në mëngjesin e 18 korrikut 1998.**

C 5.4 A është kryer sulmi nga një grup i organizuar i ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

- xxxvii. Përshkrimet e dhëna nga dy dëshmitaret për uniformat dhe armët e bartura nga individët e pranishëm në oborrin e pronës në mëngjesin e 18 korrikut 1998, përfshirë të pandehurit K dhe B, kënaqin kolegjin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se sulmi është kryer nga një grup i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (tani e tutje UÇK). Më tutje, kolegji është i mendimit se ky grup i UÇK-së ka qenë njësi e organizuar. Provat janë që një grup i konsiderueshëm i njerëzve, duke bartur uniformat e UÇK-së, duke bartur armë, kanë qenë të gjithë të pranishëm në pronë nga 17 deri më 18 korrik 1998. Kolegji përfundon se pa organizim, si pjesë e të cilit së paku një anëtar duhet ta ketë pasur udhëheqjen dhe të jep urdhra, ky grup thjeshtë nuk do të bashkohej në këtë mënyrë dhe nuk do ta kryente sulmin.
- xxxviii. **Prandaj, Kolegji është i mendimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se sulmi është kryer nga një grup i organizuar i ushtarëve të UÇK-së.**

C 5.5 Përfundimi – A janë E K dhe S B fajtorë për veprën penale Krime të luftës kundër popullsisë civile?

- xxxix. Më 29 qershor 2011, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit K, WDB i ka thënë gjykatës se në mëngjesin e 18 korrikut 1998, ‘oborri kishte qenë plot,’ dhe se i pandehuri K, në shoqëri të individëve të tjerë, ‘kalonte nëpër oborr’.
- xl. Më 4 dhjetor 2012, gjatë marrjes së tërthortë në pyetje nga avokati mbrojtës në emër të pandehurit B, WSB i ka thënë gjykatës se në mëngjesin e 18 korrikut 1998, i pandehuri B dhe të tjerët ‘ishin duke vrapuar nëpër oborr, ata shkonin nga njëra shtëpi tek tjetra. Ata merrnin gra të moshuara nga shtëpitë e tyre dhe i sillnin në oborr aty ku ne ishin duke qëndruar.’ gjatë marrjes së tërthortë në pyetje nga avokati mbrojtës, WDB i ka thënë gjykatës se i pandehuri B dhe të tjerët ‘ishin duke vrapuar nëpër oborr dhe i goditnin dyert.’
- xli. Gjykata Supreme pajtohet me vlerësimin e kolegjit të Gjykatës së Apelit për elementet e Krimeve të luftës të përcaktuara në paragrafët 27 deri në 31 të aktgjykimit të saj të 30 janarit 2014. Pas këtij vlerësimi, Gjykata Supreme është e mendimit se Serbët e pranishëm në pronë më 17 dhe 18 korrik 1998 ishin persona civil, nuk ishin duke marrë pjesë në luftime, dhe përdornin armët për mbrojtje. Kategorizimi i këtyre individëve si civil ju jep status të mbrojtur sipas nenit 3 të përbashkët me Konventën e Gjenevës të vitit 1949 dhe Protokollit Shtesë II, dhe bie nën definicionin e krimeve të Luftës kundër popullsisë civile në nenet 22 dhe 142 KPRSFJ-së, dhe neneve 31 dhe 153, paragrafëve 2.1 dhe 2.14, KPRK-së.

- xlii.** Gjykata Supreme ka ekzaminuar analizën e detajuar dhe të saktë të ligjit përfshirë jurisprudencën e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë (tani e tutje TPNJ)¹ mbi ndërmarrjen e përbashkët kriminale të bërë nga kolegji i Gjykatës së Apelit e cila është përcaktuar në paragrafët 34 deri në 41, dhe pranon këtë analizë në tërësi. Kolegji gjen se të pandehurit K dhe B ka ndarë qëllimin e njëjtë me grupin e UÇK-së, i cili ka qenë që të largojnë popullatën Serbe nga fshati, dhe kanë dhënë kontributin e tyre për këtë. Kolegji konsideron se jurisprudenca e TPNJ-së është burim legjitim i precedentit për rastet e ndjekura penalisht në Republikën e Kosovës, dhe cilëndo pjesë tjetër të ish Jugosllavisë, dhe e gjen tërësisht të përshtatshme dhe të arsyeshme që t'i referohet jurisprudencës së TPNJ-së gjatë trajtimit të rasteve të krimeve të luftës në nivelin vendorë. Në lidhje me këtë, gjykata e gjen të duhur që të konsiderohet se përgjegjësia e një personi për krime të luftës dhe krimeve të tjera të njohura ndërkombëtar bazohet në përgjegjësinë penale individuale. Sidoqoftë, përgjegjësia penale individuale mund të marrë formën e kryerjes së krimit personalisht, dhe me anë të pjesëmarrjes në grupin i cili kryen krimin. Ndërmarrja e përbashkët kriminale² është njëra e mënyrave të mundshme të pjesëmarrjes. Gjykata e ka parasysh se koncepti i atij lloji të përgjegjësisë vihen në pikëpyetje nga shkollarët dhe profesionistët e botës juridike. Sidoqoftë, ky kolegji është i mendimit se ndërmarrja e përbashkët kriminale është formë e vlefshme e përgjegjësisë, në të kundërtën do të thoshte se në të shumtën e rasteve ndjekja penale e krimeve si krimet e luftës, gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit do të ishte e pamundur.
- xliii.** **Duke pasur parasysh tërësinë e provave dhe rrethanave të këtij incidenti , kolegji është i mendimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se që të dy E K dhe S B ishin të pranishëm në pronë gjatë tërë natës së 17 korrikut, deri në mëngjesin e 18 korrikut 1998, dhe kanë luajtur rol aktiv në veprimin e kryer nga grupi i organizuar i UÇK-së.**
- xliv.** **Prandaj, kolegji është i mendimit se vepra penale Krime të luftës kundër popullsisë civile është provuar. Gjykata Supreme pajtohet me Gjykatën e Apelit dhe turpin gjykues se E K dhe S B janë fajtorë.**

C 5.6 Gjetjet e Gjykatës Supreme më 4 shtator 2012

- xlv.** Kolegji vëren komentet e bëra në ankesat pranë gjykatës në lidhje me gjetjet e aktgjykimin e mëparshëm të gjykatës së shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të 4 shtatorit 2012. Që nga lëshimi i atij aktgjykimi është mbajtur një shqyrtim gjyqësor tjetër dhe janë dëgjuar prova të mëtutjeshme nga trupi gjykues. Lënda është gjykuar pas provave pranë Gjykatës së Qarkut në Prizren më 1 shkurt 2013 kur edhe ka lëshuar aktgjykimin e saj. Gjykata e Apelit ka vendosur ankesat pranë saj më 30 janar 2014 në pajtim me provat e njëjta. Të dy gjykatat kanë mundur të bëjnë gjetjet e tyre në lidhje me provat, rrethanat dhe argumentet e paraqitura gjatë fazave individuale të procedurës. Ky kolegji vendos lëndën në shkallë të tretë duke marrë parasysh të gjitha provat e prezantuara në këtë lëndë nga fillimi deri në fund.

C 6 E K dhe S B – Dënimi

- xlvi.** Të dy të pandehurit janë dënuar me 5 vite burgim.

¹ Në veçanti, *Tadic*, numri i lëndës IT-94-1-A, aktgjykimi i 15 korrikut 1999

- xlvi.** Është korrekte që një vepër nën nenin 142 të KPRSFJ-së duhet patjetër të dënohet me jo më pak se pesë (5) vite burgim. Neni 42(2) i KPRSFJ-së në mënyrë specifike i lejon gjykatës që të zvogëlojë dënimin nën minimumin e specifikuar: '1) kur përcaktohet me status se dënimi i kryerësit mund të zvogëlohet; 2) kur gjen se ekzistojnë rrethana të tilla lehtësuese që tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me dënim më të butë.' Formulimi i dispozitës ekuivalente të KPK-së neni 66, konfirmon zbatueshmërinë, formulimi i tij duke vendosur 'apo' në mes të paragrafëve për qartësim. Prandaj, kolegji përfundon se paragrafi (2) mund të zbatohet në izolim.
- xlviii.** Pavarësisht nga fakti se të pandehurit kanë formuar pjesën e grupit i cili marrë së bashku ka shkaktuar kërcënime dhe frikë ndaj palëve të dëmtuara dhe familjeve të tyre në mes të 17 dhe 18 korrikut 1998, disa rrethanat lehtësuese duhet të merren parasysh gjatë individualizimit të dënimeve. Njëri nga të pandehurit (p.sh. K) ka bërë thirrje nga jashtë për t'i mbajtur civilët brenda në mënyrë që t'i shmanget lëndimeve të panevojshme. Dëshmitaret (palët e dëmtuara) nuk kanë qenë objekt i ndonjë trajtimi mizor, çnjerëzor, degradues apo kërcënues nga K dhe B. Dëshmitaret janë liruar pas një periudhe të shkurtër. WSB Banzić ka deklaruar më 26 tetor 2010 se gjersa ka qenë nën mbajtje atyre u është dhënë ushqim dhe se parat që u janë marrë më vonë u janë kthyer nga ushtarët e UÇK-së.
- xliv.** Përveç kësaj, nuk janë gjetur rrethana rënduese.
- i.** Rrezikshmëria e veprës penale dhe e kryerësve është shumë më e ulët në krahasim me rastet e ngjashme.
 - ii.** Kolegji gjithashtu ka parasysh kohën e cila ka kaluar që nga kryerja e veprës penale.
 - iii.** Prandaj, me mbizotërimin e rrethanave lehtësuese, siç janë regjistruar dhe në mënyrë që të arrihet qëllimi i dënimit (parandalim dhe ndëshkim) gjykata konsideron se është më se e përshtatshme që dënimet të përcaktohen sipas nenit 42 (2) *supra*, përkatësisht dënimi me "burgim prej 2 viteve", i cili është nën minimumin e përcaktuar për këtë lloj të krimit.
 - iv.** Në këtë aspekt, kolegji nuk pajtohet me vlerësimin e Gjykatës së Apelit në paragrafët 47 dhe 48 të aktgjykimit të saj të 30 janarit 2014, pasi që gjen se ekzistojnë rrethana tjera lehtësuese përveç kalimit të kohës. Kolegji nuk pajtohet me Gjykatën e Apelit se E K dhe S B duhet të dënohen në mënyrë të barabartë për veprat penale.
 - v.** Siç është cekur më lartë, kolegji e gjen proporcionale në të gjitha rrethanat që të zvogëlohet dënimi për secilin të pandehur në dy (2) vite burgim.
 - vi.** **Prandaj, E K dhe S B, secili dënohet me dy (2) vite burgim.**

C 7 N H

- lv.** Kolegji gjen se, pavarësisht faktit se vendimi mbi akuzat kundër E K nuk është akoma i formës së prerë, procedura kundër N H nuk është e kundërligjshme apo e penguar.
- lvii.** Kolegji vëren se ankesa e paraqitur në emër të N H nuk e kundërshton gjetjen e Gjykatës së Apelit se kishte dhënë deklaratë të rreme. Ankesa është paraqitur vetëm mbi bazën se deklaratat e rreme nuk përbën vepër penale sipas nenit 305 të KPK-së.
- lviii.** Çështja për përcaktimin e kolegjit është nëse akti i dhënies së deklaratës së rreme të kryer nga i pandehuri N H përbën vepër penale sipas nenit 305 të KPK-së.

- lix.** Kolegji ka ekzaminuar me kujdes formulimin e nenit 305, në mënyrë specifike ka të bëjmë me dhënien ndihmë të kryerësit për t'iu shmangur zbulimit në cilëndo mënyrë.
- lx.** Kolegji gjen se neni 305 ka të bëjë me aktet fizike të cilat e pengojnë zbulimin e kryerësit të krimit. Gjetja e kolegjit është se këto akte nuk përfshijnë dhënien e deklaratës së rreme pasi që identiteti i kryerësit tashmë është i njohur dhe në veçanti kur kryerësi tashmë është në mbajtje nga autoritetet.
- lxi.** Në këtë aspekt, kolegji pajtohet me mendimin e ndarë mospajtues të dhënë nga Gjyqtari Timo Vuojolahti gjatë procedurës pranë Gjykatës së Apelit dhe i bashkangjitur në aktgjykimin e 30 janarit 2014.
- lxii.** Kolegji e konsideron se është e panevojshme që të përsëritet e tërë përmbajtja e mendimit të ndarë në këtë aktgjykim. Mjafton të thuhet se pas shqyrtimit të detajuar dhe arsytimit të ligjit, kolegji gjen se formulimi 't' i shmanget zbulimit' i referohet periudhës kohore para se identiteti i kryerësit të veprës penale është i njohur, apo para zbulimit fizik të kryerësit, me fjalë të tjera i gjetur apo kapur.
- lxiii.** Në kohën kur i pandehuri H dhe i bashkëpandehuri i tij kanë dhënë deklaratat të rreme, kryerësi i veprës primare ka qenë i identifikuar dhe në mbajtje të autoriteteve. Prandaj, deklaratat e rreme nuk mund të thuhet se është dhënë me qëllim të dhënies ndihmë të kryerësit për t'iu shmangur zbulimit. Prandaj, deklaratat e rreme nuk mund të përbëjë vepër penale sipas nenit 305 të KPK-së.
- lxiv.** Kolegji vëren se neni 307 dënon dhënien e deklaratës së rreme gjatë procedurës gjyqësore. Ekzaminimi i versionit në gjuhët angleze dhe shqipe të KPK-së konfirmon se në nenin 307, në mënyrë specifike përmendet 'procedurë gjyqësore.' Deklarata e rreme e dhënë nga i pandehuri H dhe të bashkëpandehurit e tij nuk bie në fushëveprimin e procedurës gjyqësore, dhe prandaj ata nuk mund të akuzohen, dënohen për veprën penale sipas nenit 307.
- lxv.** Gjykata Supreme e bën të qartë se veprimi i ndërmarrë nga i pandehuri H dhe të bashkëpandehurit e tij për të penguar dhe trazuar procedurën nuk ka qenë e arsyetuar apo e pranueshme në asnjë mënyrë. Sidoqoftë, asnjëra nga veprat penale në fuqi në atë kohë nuk e mbulojnë periudhën kur i pandehuri H dhe të bashkëpandehurit e tij kanë dhënë deklaratat e tyre të rreme.
- lxvi.** Parimi themelor i nenit 2 të KPK-së dhe nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dikton se kolegji duhet patjetër të zbatojë interpretimit më të favorshëm të ligjit në fuqi në kohën aktit në fjalë. Prandaj, kolegji thjeshtë nuk mund ta interpretojë as nenin 305 e as nenin 307 për t'iu përfshirë këto deklaratat të rreme të dhëna në fazat e caktuara të hetimeve. Rrjedhimisht, dhe vetëm për këtë arsye kolegji nuk mund të gjejë të pandehurin H, apo bashkëpandehurit e tij fajtorë për veprën penale nën nenin 305 të KPK-së.
- lxvii.** **Prandaj, kolegji gjen se patjetër duhet të lirojë ankuesin N H. Duke vepruar kështu, Gjykata Supreme zbaton nenin 419 KPPK-së dhe gjithashtu liron edhe të bashkëpandehurit MH, MH, N B dhe JK.**

Kryetare e kolegjit:

Procesmbajtëse:

Elka Filcheva Ermenkova

Kerry Moyes

Zyrtare ligjore:

Natalie Dawson
Zyrtare ligjore *

Anëtarët e kolegjit:

Esma Erterzi
Gjyqtare e EULEX-it

Valdete Daka
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

*Zyrtare ligjore e EULEX-it në këtë lëndë është Natalie Dawson. Natalie Dawson ka qenë e pranishme në seancën e Gjykatës Supreme dhe ka bërë punën përgatitore dhe ka përpiluar draftet në këtë lëndë. Natalie Dawson nuk ka qenë në dispozicion në ditën kur kolegji është këshilluar dhe ka marrë vendimin. Kerry Moyes ka vepruar si procesmbajtëse në emër të Natalie Dawson, vetëm gjatë këshillimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

PA II 3/2014

7 gusht 2014